**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E BUJQËSISË**
**ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRMIT TË UJËRAVE**
**KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

# VENDIM

Nr._5_ Data_04.08.2017_

**Për mos miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në përroin e Hormovës, dega e lumit Drino, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hormovë" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Gjirokastër, Qarku e Gjirokastër subjektit "Sulaj" sh.p.k., me administrator Z. Banush Sulaj**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016,** Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni",**

## VENDOSI

Mos miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në përroin e Hormovës, dega e lumit Drino, dega e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hormovë" për prodhim të energjisë elektrike, Rrethi Gjirokastër, Qarku e Gjirokastër subjektit "Sulaj" sh.p.k., me administrator Z. Banush Sulaj me këto të dhëna:

Koordinatat: X44 23 322.146; Y44 56 289.786; Z 362

Prurja mesatare: 0.117 m3/sek

Prurja e llogaritur: 0.117 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.117 m3/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritetet të jetë **200 *kW***

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I K.B.U "VJOSË"**

**Etjona HOXHA**

**PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"**

**Ilir PROFKA**